

**Qendra Shqiptare e Studimeve të
Luftës Kundër Terrorizmit dhe
Krimit të Organizuar**



***KERKIMI, IDENTIFIKIMI DHE
GJETJA E PESONAVE TE
HUMBUR E TE TRAFIKUAR***

2007

Agjencia
Kërkimit dhe
Identifikimit

PËRMBLEDHJE

Projekti “ Kërkimi, identifikimi dhe gjetja e fëmijëve të humbur dhe të trafikuar “ ka për qëllim grumbullimin e informacioneve të dobishme dhe identifikimin përmes këtyre informacioneve dhe të dhënave të fëmijëve të humbur dhe të trafikuar në vendet fqinje e më gjerë dhe bashkëpunimin me organet e specializuara shtetërore, institucionet e misionet ndërkombëtare dhe me organizatat e kujdesit për fëmijët në kuadrin e Konventës 44 / 25 te 2 Shtatorit 1990 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB “ Për të drejtat e fëmijëve” dhe “ rregullat standard minimum për administrimin e drejtësisë për fëmijët” (Rregullat Beijing) Rezoluta 40 / 33 e 29 Nëntorit 1985, për të mundësuar sjelljen e tyre pranë familjeve.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës, në ligjet e shtetit shqiptar, në standardet ndërkombëtare dhe në misionin e Qendrës Shqiptare të Studimit të Luftës kundër Terrorizmit dhe Krimit të Organizuar, ky projekt do të shërbejë edhe për evidentimin e listës së plotë të fëmijëve të trafikuar dhe të përdorur nga krimi i organizuar, fëmijët që aktualisht ndodhen në burgje në vendet ku kanë emigruar apo janë trafikuar, edhe për dhënien e ndihmës së përshtatshme juridike e profesionale për një gjykim të drejtë sipas konventave ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve

ABSTRAKT

Ne e vlerësojmë të një rëndësie të veçantë nisjen dhe nxitjen e veprimtarisë për kërkimin, identifikim dhe gjetjen e fëmijëve dhe personave të humbur e të trafikuar për faktin se kjo përbën një dukuri mjaft shqetësuese të shoqërisë shqiptare të kësaj periudhe të një tranzicioni të gjatë e të vështirë drejt demokracisë, për faktin se pavarësisht nga përpjekjet e bëra në mënyrë sporadike dhe jo sporadike dhe jo profesionale nga individë e organizata, problemi vazhdon të mbetet mjaft i mprehte dhe shqetësues. Vetëm në shtetin Grek, nga informacionet që kemi sipas burimeve zyrtare dhe mediatike greke dhe nga korrespondentet e disa medieeve elektronike shqiptare në vendin fqinj grek, janë rreth 2000 te burgosur shqiptare, ku 37 % e të cilëve janë fëmijë dhe të rinj. Ndërsa nga emisionet e kanalit televiziv në Vizion Plus dhe NEW 24 evidentohen njoftime e shqetësime për mjaft të rinj që kanë humbur lidhjet me familjet e tyre apo konsiderohen të zhdukur.

Duke u bazuar në misionin, objektivat dhe kualifikimet e anëtarëve të Qendrës Shqiptare të Studimit të Luftës Kundër Terrorizmit dhe Krimit të Organizuar, kemi aftësitë dhe kualifikimet e nevojshme për të arritur me sukses qëllimin dhe objektivat e këtij projekti, duke dhënë kontributin tonë për minimizimin dhe eliminimin e një shqetësimi të tillë, veç të tjerash dhe për faktin se nga informacionet e deritanishme që kemi na rezultojnë se shumica dërmuese e fëmijëve të humbur në vendet ku kanë emigruar kanë qene ose janë viktime të trafikëve të qenieve njerëzore nga organizatat e krimit, janë përdorur si shpërndarës, lypës, killer, prostituta minorene në rrjetet e pedofilisë apo janë trafikuar për transplantim organesh.

Ne besojmë se ky është një objektiv i arritshëm nëse bashkohen forcat dhe gjenden mjetet e nevojshme dhe të profesionalizuara për zgjidhjen e këtij problemi mjaft delikat dhe të vështirë. Harxhimi i forcave, mjeteve dhe përpjekjeve në këtë fushë është me rëndësi sepse ndihma për gjetjen dhe kthimin e fëmijëve pranë familjeve ka të bëjë me kujdesin e shoqërisë për të ardhmen e saj dhe me përpjekjet për të parandaluar një nga shkaqet e përhapjes së krimit të organizuar.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi ynë është që përmes kërkimit në informacionet e shtypit dhe të publikuara nga organet kompetente, në kontaktet me anëtarët dhe të interesuarit në degët tona nëpër rrethe, me sektorët e specializuar të Policisë së

Shtetit, me Avokatin e Popullit, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Ambasadat e akredituara në Tirane dhe ne Ueb të krijojmë database-n e nevojshme për katalogimin dhe identifikimin e të gjithë fëmijëve të humbur apo të trafikuar. Rezultatet e kësaj faze do të krahasohen me të dhënat zyrtare për fazën e dytë që do punohet për gjetjen, marrjen kontakt dhe në fazën e tretë do të ndërmerren hapat konkretë në vende për ndihmën e kualifikuar profesionale dhe asistencën juridike për t'i kthyer pranë familjeve të tyre.

Projekti do të fillojë me një punë paraprake për grumbullimin, sistemimin, studimin dhe katalogimin e të gjithë informacionit të disponueshëm nga burimet zyrtare dhe informale. Gjatë kësaj faze, do të funksionojë në mënyrë permanente një shërbim fulltime i marrjes së kontakteve telefonike dhe i plotësimit të kartelave për çdo të kërkuar të mitur, për çdo të humbur apo të trafikuar. Një numër telefoni "free" dhe një adresë e-mail do të jetë në pritje për të lehtësuar marrjen e njoftimeve nga të interesuarit, familjarët dhe të afërmit. Çdo degë e Qendrës në rrethe do të caktojë një njeri për të pritur informacione dhe kërkesa nga qytetarët për fëmijë të humbur. Do të përgatitet një spot sensibilizimi, një njoftim për shtyp dhe një flet-palosje për gatishmërinë dhe mënyrat e kontaktit me projektin në ndihmë të të interesuarve. Do të këmbehen informacionet në tryeza të përbashkëta pune me Ministrinë e Brendshme, me Prokurorinë dhe Ministrinë e Drejtësisë dhe do të hartohet një plan veprimi i përbashkët për fazën e dytë dhe të tretë. Për çdo fëmijë të humbur që kërkohet nga të afërmit apo rezulton i pa identifikuar nga institucionet shtetërore do të përgatitet një dosje e veçantë të dhënash dhe do të administrohet në qendrën e projektit (ne QSHSLKTKO). Do të zhvillohet një Workshop me të gjithë personat që do të përfshihen në projekt, për të njohur dhe aftësuar në grumbullimin, sistemimin dhe përpunimin e informacioneve.

Në muajin Mars 2007 do të fillojë faza e dytë, kërkimi, gjetja e vendndodhjes dhe identifikimi i fëmijëve të evidentuar dhe kataloguar. Fillimi i fazës së dytë, nuk presupozon mbylljen e fazës së parë e cila të vazhdojë gjatë gjithë projektit, por aktivizimin e resurseve të qendrës për kërkimin, identifikimin dhe gjetjen e vend-ndodhjes në terren të fëmijëve të evidentuar si të humbur.

Marrja e rezultateve të para në objektivat e fazës së dytë, shënon dhe fillimin e fazës së tretë, atë të bashkëpunimit me organet zyrtare shqiptare dhe të vendit ku ndodhet fëmija për ndihmën profesionale dhe juridike për kthimin në familjet e tyre. Kjo sepse ka fëmijë që në vendet ku ndodhen kanë probleme me drejtësinë dhe për këtë duhet ndihmë juridike, që sipas informacioneve që kemi u mungon ose ka qenë e pamjaftueshme. Gjithashtu mjaft prej tyre janë ende nën ndikimin e trafikuesve dhe të tutorëve të krimit të organizuar, prandaj duhet edhe një suport profesional për shkëputjen e tyre pa u dëmtuar.

SFONDI SOCIAL I PROJEKTIT.

FAKTORË SOCIALE E PERSONALE

- Tranzicioni i zgjatur dhe i vështirë social, politik dhe ekonomik i vendit paraqet një numër faktorësh që influencojnë në mbajtjen e një klime pasigurie dhe terren të favorshëm për veprimtarinë e organizatave kriminale të trafikimit dhe terrorizmit.
- Problemet tradicionale, tradita zakonore e gjakmarrjes, diferencat në kulturat krahinore apo racore, zhvendosjet e shpeshta migratore të popullatës drejt qyteteve, veçanërisht drejt kryeqytetit dhe emigracioni legal apo ilegal kanë krijuar një pikturë heterogjene të përbërjes së komuniteteve dhe kanë sjellë shume shpesh humbjen e lidhjeve midis të emigruarve në vende të tjera dhe të afërmeve të tyre në Shqipëri.
- Problemet e reja të rrjedhura nga një tranzicion i vështirë; përhapja e korrupsionit, politikat konfliktuale të ndjekura gjatë këtyre viteve nga forcat politike dhe reflektimi i tyre në jetën

sociale; veprimtaria dhe sofistikimit i veprimtarisë së organizatave kriminale shqiptare dhe ndërkombëtarizimi i lidhjeve të tyre; mungesat në aftësimin, në kompetencën profesionale dhe prania e njerëzve të inkriminuar e të përfshirë në këto veprimtari dhe brenda organeve të zbatimit të ligjit dhe mungesat në njohjen dhe ndjeshmërinë sociale të stafit dhe të trupës në polici lidhur , e problemet sociale të kohës nga njëra anë kanë krijuar shpesh terren të favorshëm për lulëzimin e veprimtarive të trafikimit të fëmijëve për qëllime prostitucioni, për transplanto organesh, për birësime kriminale, për shfrytëzim të punës së zezë dhe për përdorimin e tyre si forca operative të grupeve kriminale; nga ana tjetër kanë ulur efektivitetin e përgjigjes efikase nga organet e zbatimit të ligjit apo e kanë orientuar në ato drejtime ku dhe ka më tepër presione nga konjunkturaturat politike të momentit dhe media duke lënë pas dore krime të tjera më pak të dukshme.

- Problemet psikike e familjare, sociale ekonomike, diferencat nënkulturore krahinore dhe në veçorinë e mënyrës së jetesës kanë krijuar një tablo të larmishme të shtrirjes gjeografike të llojeve të veprimtarisë së organizuar kriminale të fokusuar tek fëmijët dhe të rinjtë; në disa zona janë më të përhapura përfshirja në përdorimin dhe shpërndarjen e drogës, në disa ka më tepër përhapje trafikimi për prostitucion apo për transplanto organesh, në disa të tjera për t'i përdorur si lypsa, për punë të zezë, apo si forca goditëse duke shfrytëzuar lehtësitë që krijojnë legjislacionet e vendeve të ndryshme ndaj fëmijëve; janë disa nga shkaqet që ndikojnë negativisht në situatën dhe problemet në lidhje me kujdesin që duhet të tregojë shoqëria dhe organet e zbatimit të ligjit ndaj fëmijëve dhe në luftën kundër krimit të organizuar.

FAKTORË ORGANIZATIVË

- Paqëndrueshmëria dhe paqartësia strukturore, kushtet dhe mjetet e papërshtatshme të punës dhe të jetës, mungesat e dukshme në përzgjedhjen e personelit sipas kriterëve profesionale, pamjaftueshmëria e aftësive të trajnuara, trysnia politike e vazhdueshme lidhur me vendet e punës pavarësisht aftësive, pagat e pamjaftueshme dhe shtrirja e fenomenit të korrupsionit në zyrtarët e zbatimit të ligjit.
- Paqartësitë në njohjen e detyrave funksionale të rrjedhura në mungesat në përcaktueshmërinë ligjore të tyre dhe nga mungesat e një trajtimi specifik;
- Pamjaftueshmëritë në kompetencën profesionale dhe në struktura të mirëfillta kërkimore e studimore për njohjen dhe identifikimin rigoroz shkencor të problemeve dhe prirjeve të veprimtarisë kriminale ndaj fëmijëve dhe të rinjve.
- Natyra kryesisht akuzatore dhe metodat proaktive të përdorura ndaj krimit të organizuar nga organet e zbatimit të ligjit lënë shpesh pas dore thirrjet e qytetarëve për ndihmë në gjetjen e fëmijëve dhe personave të humbur që nuk rrjedhin nga veprimtaria kriminale e brendshme apo që kanë ndodhur për shkaqe sociale;
- Mungesa e ekspertëve të mirëfilltë për konsultën, kërkimin, identifikimin, gjetjen dhe mbrojtjen ligjore për fëmijët, përbëjnë pamjaftueshmëri të organeve të zbatimit të ligjit dhe shkak për të ndërhyrë në këtë fushë dhe një problem ligjor për t'u studiuar e zgjidhur.

PËRFITUESIT

Përfituesi i parë.

Fëmijët: fëmijët, të rinjtë në veçanti por edhe persona të tjerë të humbur apo të deklaruar të zhdukur do jenë përfituesit kryesorë për shkak se jo vetëm do të ndihmohen për të rivendosur lidhjet e humbura familjare, por sepse do të ndjejnë kujdesin e shoqërisë ndaj tyre (mungesa e tij shpesh i shtyn të largohen nga familjet dhe të shkëpusin lidhjet me to) dhe për më tepër do të ringrënë mundësinë për t'u shkëputur nga kthetrat e grupeve kriminale nga të cilat e kanë vështirë të largohen dhe do të marrin mbrojtjen e nevojshme ligjore të munguar (por që e gëzojnë si të drejtë të ligjshme universale).

Përfituesit e dytë

Prindërit: prindërit dhe familjarët e tyre do të jenë përfitues të dytë nga projekti sepse mjaft prej tyre nuk kanë mjete të mjaftueshme për të realizuar një nevojë, një detyrim shoqëror dhe një të drejtë për të gëzuar një jetë familjare të shëndetshme dhe për të realizuar përgjegjësitë e tyre si prindër. Kushtet ekonomike dhe sociale shpesh i kanë detyruar të mos veprojnë dot apo të pranojnë kushtet viktimizuese e kriminalizuese të grupeve kriminale dhe për fëmijët e tyre. Dhënia e një pikë mbështetje profesionale e ligjore do t'i shkëpuste edhe këta të fundit nga vartësia e krimit të organizuar apo nga kërkesat për të paguar në mënyrë të paligjshme për të kërkuar e gjetur fëmijët e tyre.

Përfituesi i tretë

Shoqëria: Shoqëria shqiptare dhe më gjërë përfitojnë nga projekti sepse demonstrojnë vullnetin e tyre dhe kujdesin për të ardhmen, për garantimin e barabartë të lirive demokratike për shtetasit shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, zvogëlon riskun e dëmtimet që i vijnë nga veprimtaria e organizuar kriminale dhe terrorizmi. Në një plan më të gjerë rajonal e ndërkombëtarë shoqëria do të përfitonte nga projekti edhe në kuadrin e një koordinimi të forcave e përpjekjeve në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit edhe për faktin se duke shpëtuar fëmijët dhe të rinjtë nga kthetrat e krimit dhe nga ndikimi i tij do të pengonte një nga shkaqet e përhapjes së tij në të ardhmen.

KRITERET E MATJES SË SUKSESIT.

Kriteri i parë:

Grumbullimi, katalogimi dhe ndërtimi i database për personat dhe fëmijët e humbur, të trafikuar, të zhdukur apo të burgosur jashtë Shqipërisë. Studimi dhe sensibilizimi i organeve dhe organizmave të vendit dhe më gjërë për përmasat e problemit dhe përcaktimi i masave për zvogëlimin e tij. Studimi i trendit, modës, shtrirjes gjeografike, problematikës dhe shkaqeve të tyre.

Kriteri i dytë:

Kërkimi, identifikimi dhe gjetja e personave të evidentuar si të humbur, të zhdukur apo të burgosur, që kanë humbur lidhjet me familjet e tyre sipas numrit të afateve të krahasueshme me raste të ngjashme nga projekte të mëparshme dhe eksperiencat botërore të kësaj fushe.

Kriteri i tretë:

Përbushja në kohë dhe në vend i masave të përcaktuara në marrëveshjet e bëra me palët e përfshira në projekt si partnerë, ekspertë, anëtarë dhe të interesuar. Organizimi dhe përdorimi me efikasitet, rendiment dhe sipas ligjit i burimeve njerëzore, i mjeteve materiale dhe financiare të projektit.

KËRKESA DHE KUSHTE PARAPRAKE

1	Sensibilizimi	Artikuj, intervista	Seminar	Konference	Botime
2	Infrastruktura	Zyrat e pritjes	Free tel.	Autoveturë	Kancelari
3	Stafi	Drejtuesi projektit	Database	Kërkuesit	Mbrojtja ligjore

KËRKESA E PARË

Trajnimet: Trajnime speciale e të thelluara të stafit dhe personave të tjerë të përfshirë si partnerë në projekt për krimin e organizuar, natyrën e moshave rinore dhe metodat e gjetjes së personave të humbur.

Sensibilizimi: Sensibilizimi i opinionit publik, mediatic, shoqërisë civile dhe organeve shtetërore e organizatave ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri dhe rajon për problematikën e projektit dhe nevojën për një bashkëpunim e partnership sa më të gjerë.

KËRKESA E DYTË

Infrastruktura dhe logjistika: Ndërtimi dhe vënia në efikasitet e mjediseve të punës së stafit dhe bashkëpunëtorëve të projektit për marrjen e informacioneve. Përpunimin shkencor kompjuterik e statistikor të të dhënave të grumbulluara nga burime të ndryshme si intervistat me të interesuarit që kërkojnë njerëzit e tyre, të të dhënave nga burimet dokumentare zyrtare e mediatike, të dhënat dhe informacionet nga bashkëpunëtorët konfidenciale. Ndërtimi dhe vënia në funksion të projektit e degëve të QSLKTKO në rrethe dhe shkëmbimi i informacioneve me to në mënyrë permanente dhe të sigurt. Ndërtimi dhe vënia në efikasitet i shkëmbimit të informacioneve me rrugë të sigurta ligjore me organet e zbatimit të ligjit dhe me partnerët ndërkombëtarë.

KËRKESA E TRETË

Stafi: përzgjedhja, trajnimi dhe caktimi në detyrë i njerëzve (hartimi i “ job description” për çdo rol, përcaktimi i masës së punës dhe të shpërblimit, të drejtat dhe detyrat sipas roleve).

QËLLIMI

Qëllimi ynë është që përmes kërkimit në informacionet e shtypit dhe të publikuara nga organet kompetente, në kontaktet me anëtarët dhe të interesuarit në degët tona nëpër rrethe, me sektorët e specializuar të policisë, me Avokatin e Popullit, me Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Ambasadat e akredituara në Tiranë dhe në Ueb të krijojnë database-n e nevojshme për katalogimin dhe identifikimin e të gjithë fëmijëve të humbur apo të trafikuar. Rezultatet e kësaj faze do të krahasohen me të dhënat zyrtare për fazën e dytë që do të punohet për gjetjen, marrjen kontakt dhe në fazën e tretë do të ndërmerren hapat konkretë në vende për ndihmën e kualifikuar profesionale dhe asistencën juridike për t'i kthyer pranë familjeve të tyre.

METODAT

1. **Faza e parë:** kërkimi dokumentar, intervistimi, katalogimi, hartimi i fashikujve me të dhënat.
2. **Faza e dytë:** kërkimi në terren, kontaktet e personave të kontaktit të projektit në vendet ku rezultojnë të jenë të kërkuarit dhe aktivizimi i tyre për identifikimin e personit dhe vendndodhjes së tij. Udhëtime, vëzhgime, masa sigurie.
3. **Faza e trete:** Masa sigurie, vëzhgime, ndihmë juridike, udhëtime.

ÇFARE DO TË ARRIHET?

Nga projekti do të arrihet:

- sistemimi dhe studimi i hartës së trafiqeve të fëmijëve dhe ndërtimi i database-s të të dhënave rreth veprimtarisë së grupeve e organizatave kriminale që trafikojnë dhe përdorin fëmijët.
- sensibilizimi i organeve shtetërore për hartimin e një legjislacioni më të përshtatshëm dhe marrjen e masave strukturore e organizative për mbrojtjen e fëmijëve.
- identifikimi dhe gjetja e fëmijëve të humbur apo të trafikuar dhe shpëtimi i tyre.

AFATET DHE ETAPAT

- **Faza e parë**
Mars 2007 - Gusht 2007
- **Faza e dyte**
Shtator 2007 - Vazhdim
- **Faza e trete**
Vazhdim

ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E PROJEKTIT (STAFI)

Stafi i Projektit				
Nr.	Personi	Përgjegjësia	Mbikëqyrësi	Nr. Telefonit
1.		Lideri Projektit	Drejt. Ekzekutiv	
2.		Punonjës database.	Lideri Projektit	
3.		Punonjës database.	Lideri Projektit	
4.		Ekspert statistike	Lideri Projektit	
5.		Kërkues terreni	Lideri Projektit	

Personat e kontaktit nga donatorët dhe partnerët potencialë.

Emri _____

Adresa _____

Adresa e-mail _____

Nr. Tel _____

Personat e kontaktit nga donatorët dhe partnerët potencialë.

Emri _____

Adresa _____

Adresa e-mail _____

Nr. Tel _____

Personat e kontaktit nga donatorët dhe partnerët potencialë.

Emri _____

Adresa _____

Adresa e-mail _____

Nr. Tel _____

DREJTORI EKZEKUTIV

Maksim Ferra

Janar 2007